

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“Himara Rental” shpk**

Sot, në datë 30.05.2024, unë themeluesi, Theotaq Gjergji, atësia Lefter, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal J41010057S, i datëlindjes 10.10.1994, lindur në Greqi dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtme.

**Neni 1:  
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është “Himara Rental” shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:  
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: Dhënia me qira e pasurive të paluajtshme: ofrimi i dhënies me qira afatshkurtër dhe afatgjatë, të apartamenteve, vilave, rezidencave, zona të banimit, shtëpi pushimi, ambiente biznesi, konferenca, garazhe, ambiente të hapura dhe shërbime e aktivitete të tjera të ngjashme. Ofrimi i shërbimeve të tjera mbështetëse që lidhen ngushtë me aktivitetin e dhënie me qira: punime mirëmbajtje dhe rikonstruksioni ambientet, punime të ndryshme ndërtimore, ndërmjetësimi për shpenzime të përbashkëta dhe të nevojshme si transporti, shërbim pastrimi, shërbim lavanderie, shërbim parkimi, shërbim guida dhe informacione të tjera ndaj pushuesve dhe veprimtaritë e tjera të nevojshme që lidhen ngushtësisht me këtë aktivitet. Shoqëria, në të ardhmen, gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm dhe që e gjykon të nevojshme.

**Neni 3:  
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:  
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Himarë - Spile ,Qendër; Ap. Nr 11; Kati 4 – Blloku; HIMARE.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 5:  
Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 12,000 (Dymbëdhjetë mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuota, që zotërohet plotësisht nga ortaku Theotaq Gjergji.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

**Neni 6:  
Akti i Themelimit**



#### **Administratori**

- 1) Administrator i shoqërisë emërohet Theotaq Gjergji, shtetase shqiptare, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal J41010057S i datëlindjes 10.10.1994, lindur në Greqi dhe banues në Tiranë, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

#### **Neni 7:**

#### **Baza Ligjore**


- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 8:**

#### **Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**ORTAK I VETËM  
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR "Himara Rental" shpk**

  
Theotaq Gjergji  
(Emër, Mbiemër, Firma)